



BASHKIMI EVROPIAN

Delegacioni i Bashkimit Evropian

Shkup, 23 nëntor 2012

**10 Vjetori i Agjencisë për mbikëqyrje të financimit kapital të
sigurimit pensional – MAPAS
dhe**

eveniment për shënimin e mbylljes – projekt të IPA 2008
**Përkrahje të Agjencisë për mbikëqyrje të financimit kapital
të sigurimit pensional**

E hënë, 26 nëntor 2012
Holiday Inn, Shkup

Fjalim
z. Lukaś MELKA, Shef i sektorit

I nderuar Mnistër Ristovski,
I nderuar Drejtor Dervishi,
Të nderuar mysafir

Të nderuar miq,

Sot jemi tubuar që ta shënojmë dhjetëvjetorin e ekzistimit të Agjencisë për mbikëqyrje të financimit kapital të sigurimit pensional – MAPAS dhe mbylljen e projektit përmes të cilit Bashkimi Evropian siguroi ndihmë teknike për MAPAS. Siguria dhe efikasiteti i skemave pensionale kanë rëndësi të jashtëzakonshme për qytetarët e Bashkimit Evropian. Legjislacioni i BE-së bazohet mbi parimin e harmonizimit minimal dhe njohjes reciproke. Të gjithë jemi të vetëdijshëm për trendet demografike të cilat na obligojnë për të ndërmarrë aktivitete me qëllim që të sigurojmë që personat që do të pensionohen në të ardhmen të kenë pension të përshtatshëm. Krahas kësaj, krizën të cilën jemi duke e përjetuar na shtyn që të ndërmarrim masa të fuqishme për ti mbrojtur pensionistët dhe që tu mundësojnë fondeve pensionale ta luajnë rolin e tyre si stabilizues ekonomik. Andaj, Komisioni miratoi këtë vit një varg të iniciativave të cilat do të sigurojnë mbrojtje në shtetet anëtare të BE-së, që do të synojnë:

- Zhvillim dhe punësim;
- Përdorim më të mirë të tregut të vetëm;
- Promovim të investimeve afatëgjate;
- Qëndrueshmëri të financave publike të shteteve anëtare të BE-së;
- Mundësi të barabarta për konkurrencë rregullatore.

Zonja dhe zotëri, siç u përmend më parë, kapitulli për shërbime financiare ka rëndësi të madhe për Bashkimin Evropian, sidomos në kohë të krizës dhe efektet që mund të shkaktohen në ekonomin nacionale nga mungesa e mbikëqyrjes adekuate të sektorit financiar. Përmes projektit që jemi duke e mbyllur sot, kemi siguruar asistencë që do ti ndihmoj MAPAS-it ti përforcoj kapacitetet e saja për kryerjen efikase dhe efektive të funksionit mbikëqyrës dhe të rris besueshmërinë ndaj fondit pensional. Në afat të gjatë, kjo është rëndësia kryesore e sistemit pensional, e cila do të garantoj qëndrueshmëri afatgjate.

Objektivi i përgjithshëm i projektit të financuar nga BE-ja “Përkrahje të Agjencisë për mbikëqyrje të financimit kapital të sigurimit pensional” ishte forcimi i kapaciteteve institucionale për mbikëqyrje të institucioneve të financimit kapital pensional, që do të rezultojë me sektor më transparent dhe më të

besueshëm të sigurimit pensional. Ky projekt, MAPS-it i siguroj ndihmë teknike për forcimin e praktikave përmes zhvillimit të kapaciteteve dhe menaxhim të përmirësuar organizativ përfshirë edhe planifikim strategjik dhe planifikim të biznesit , integrimin e mbikëqyrjes për analizë të rrezikut, procese për punë, menaxhim hulumtim/njohuri dhe zhvillim të IT-së. Por, më vonë do të dëgjoni më shumë për projektin dhe për tre komponentët nga ekipi i projektit.

Projekti me buxhet prej gati 1 milion euro filloi më 1 janar të vitit 2011 dhe do të përfundoj muajin e ardhshëm. Në këtë rast dua tu falënderohem të gjithë atyre që ishin të kyçur në implementimin e projektit, për përpjekjet e tyre, dedikimin e tyre dhe durimin. Në fund më lejoni ti përshëndes të punësuarit të MAPAS-it dhe t'ju uroj punë të suksesshme në të ardhmen.

Ju falënderoj për vëmendjen tuaj.